



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 85-Korrik- 2010 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>





PËRMBAJTJA:

Kryetari Kilaj priti drejtorin regjional të OSBE-së F. Carlier	3
Mbyllet tregu i gjelbër	4
Komuna dhe komuniteti i biznesit ofrojnë mbështetje reciproke	4
Situata e sigurisë e qetë dhe stabile.....	5
Kilaj e Kvale inspektuan punimet në Qendrën e Kompetencës.....	6
Këshilltarët shkojnë në pushim veror	7
Dëgjon hallet e tyre dhe ofron përkrahje	8
Fillon fushata e korrjeve-shirjeve	8
Kërkohej përgjegjësi në punë për shërbime efikase ndaj bashkatdhetarëve.....	9
Ansamblu “Llapusha” nga Malisheva merr pjesë në festivalin ballkanik në Turqi	10
Në Qendrën e Kompetencës regjistrohen nxënësit e parë	11
Asnjë semimaturant nuk do të mbetet jashtë bankave shkollore	12
Fillon asfaltimi i rrugës në gjatësi 4 kilometra	13
Blegtorët e Malishevës përfitojnë afro 100 mijë euro nga subvencionimi	14
KD :“Të ndihmohen familjet me ujë të pijes”	14
Komuna dhe CHF do të ndërtojnë aneksin e shkollës në Marali.....	15
OSBE prezanton kornizën ligjore për qasje në dokumentet zyrtare	16
Kryetari Kilaj i premtan mbështetje financiare, pilotit lobues James Berisha	16

Kryetari Kilaj priti drejtorin regional të OSBE-së F. Carlier

Malishevë, 1 korrik

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur sot në takim, drejtorin regional të OSBE-së në Prizren, Francis Carlier. Vizita kishte karakter njoftues, me ç'rast drejtori regional i OSBE-së, ka prezantuar zyrtarin e ri të ekipit komunal të OSBE-së në Malishevë, Umit Aynaci, si dhe është diskutuar mundësia e përfshirjes së OSBE-së në fushatën kundër etheve hemorragjike.



Kryetari Kilaj, ka falënderuar drejtorin e OSBE-së për këtë vizitë si dhe për interesimin e tij në lidhje me rrjedhat e përgjithshme në Malishevë. Po ashtu kryetari Kilaj, i është përgjigjur edhe interesimit të tij, për situatën epidemiologjike.

Fillimisht Carlier, ka shfaqur idenë e tij, për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të

Demokracisë me 17 shtator të këtij viti, e cila parashihet të koordinohet me kryetarët e komunave, dhe e cila përfshinë aktivitetet e ndryshme.

Ndërsa sa i përket situatës së etheve hemorragjike, kryetari Kilaj ka pohuar se “ne si komunë kemi ndërmarrë hapa konkret në masat parandaluese kundër infektimit nga ethet hemorragjike, përmes fushatave të informimit si dhe spërkatjes selektive”, duke shtuar se dhe kjo është mundësia që ka komuna, ndërsa situatën në tërësi e vlerësoj si çështje që duhet marrë nivelin qendror.

Francis Carlier, drejtor i OSBE-së, për regjionin e Prizrenit, ka diskutuar edhe për mundësinë e përfshirjes së Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH).

“Ne, përmes mjekëve të OSBE-së, do të shikojmë të gjitha mundësitë e përfshirjes së OBSH-së në këtë situatë”, tha Carlier.

Carlier, është interesuar edhe për situatën me ujë të pijshëm, kurse kryetari Kilaj, e ka njoftuar atë, se komuna, çdo vit investon në ndërtimin e ujësjellësve, duke marrë shembuj konkret, siç ishte përrurimi i ujësjellësit për tri fshatra kohëve të fundit, si dhe nënshkrimin e marrëveshjes me USAID-in, për ndërtimin e ujësjellësit për dy fshatra tjerë, Turjakë e Burim.

Për shkak të obligimeve ndaj komunës

Mbyllet tregu i gjelbër

Malishevë, 1 korrik

“Sot që në orët e hershme të mëngjesit, është mbyll tregu i gjelbër në qytetin e Malishevës, për shkak se pronari i këtij tregu, nuk ka kryer obligimet ndaj komunës”, kështu ka bërë të ditur shefi i inspektoratit të komunës, z. Ahmet Morina. Kjo mbyllje pason pas disa vërejtjeve që i janë bërë pronarit, nga ana e inspektorëve komunal.

Ky aksion është shoqëruar edhe nga Policia e Kosovës në Malishevë, ndërkohë bëhet e ditur se nuk do të lejohet hapja e tregut, deri sa pronari i tij nuk kryen obligimet ndaj komunës. Sipas z. Morina në shënjestër të Inspektoratit komunal janë edhe tregjet tjera të cilat funksionojnë në komunën e Malishevës, e të cilat kanë obligime ndaj komunës.

Në këtë kontekst është bërë e ditur edhe për disiplinimin e daullexhinjve nga Shqipëria, të cilët Sheshin e Dëshmorëve në qytet e shfrytëzojnë si treg pune duke krijuar kështu edhe një zhurmë të kundërligjshme.

Komuna dhe komuniteti i biznesit ofrojnë mbështetje reciproke

Malishevë, 2 korrik

Komuna dhe kryetari i saj z. Isni Kilaj, vazhdojnë të përkrahin shoqatën e biznesit, përderisa edhe biznesi, do të përkrah praktikën profesionale të mësimdhënësve të Qendrës së Kompetencës, duke ofruar kryerjen e praktikës së tyre, në kompanitë e komunës së Malishevës.





Kështu u tha sot, në një takim të Kuvendit të Shoqatës së Bizneseve në Malishevë, ku kryetari i bordit të kësaj shoqate, Daut Krasniqi, pasi prezantoi punën e deritanishme të saj, falënderoi komunën dhe kryetarin Isni Kilaj, për mbështetjen që po i jep shoqatës së bizneseve në Malishevë.

“Shoqata është adresa juaj për të gjitha gjërat përfshirë këtu fondet, stimulimet që bëhen përmes mekanizmave vendor dhe ndërkombëtare, siç është Zyra Regjionale e Bashkimit Evropian për Zhvillim, fondet stimuluese të Qeverisë së Kosovës dhe të tjera”, tha kryetari Isni Kilaj.

Më pas, drejtori i Qendrës së Kompetencës, Besim Dobruna, i njoftoi bizneset për aktivitetet e QK-së, qëllimet dhe profilet e saj, ndërsa marrëdhëniet me biznesin, i quajti kruciale, pasi pjesëmarrja e biznesit në hartimin e planë-programeve, është shumë me rëndësi për arritjen e qëllimeve të punës së QK-së.

“Për ti arritur këto, ne kemi nevojë që mësimdhënësit tanë, të kryejnë praktikën profesionale, për dy muaj në bizneset tuaja, në mënyrë që ata të jenë edhe më të përgatitur profesionalisht në fushat e caktuara dhe të aftësohen për mësimdhënie praktike, prandaj kyçja e biznesit në këtë drejtim, është shumë me rëndësi për ne”, ka thënë drejtori Dobruna, i cili edhe mori mbështetjen e komunitetit të biznesit.

Biznesmenët e Malishevës, nga drejtori për bujqësi, z. Sinan Kryeziu, u njoftuan për fondet stimuluese të Ministrisë së Bujqësisë, në veçanti në perimekulturë, për zhvillimin e veprimtarive në pemëtarë dhe vreshtarë.

Në komunën e Malishevës

Situata e sigurisë e qetë dhe stabile

Malishevë, 6 korrik

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), e vlerësoi të qetë dhe shumë stabile situatën e sigurisë së përgjithshme në territorin e komunës së Malishevës, në veçanti muajin Qershor, duke përjashtuar aksidentet në trafik, të cilat shënojnë rritje.

Këtë vlerësim e kanë dhënë, anëtarët e KKSBB-së, në takimin e pastë të radhës, ku sipas drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z. Halit Zogaj, edhe muaji qershor ka qenë muaj i qetë, ndërsa njoftoi për vazhdimin e fazës së dytë të spërkatjes selektive, kundër rriqrave, si masë parandaluese kundër infektimit me ethe hemorragjike.

Edhe Policia e Kosovës, e vlerësoi të qetë situatën e sigurisë së përgjithshme, pasi nuk është shënuar asnjë rast që do ta rrezikonte sigurinë, përderisa aksidentet në trafik vazhdojnë të mbesin sfidë për Policinë e Kosovës, pasi po shënohet rritje e aksidenteve.



“Krahasuar me gjashtë mujorin e parë të vitit të kaluar, këtë gjashtë mujorë, ka një rritje prej dhjetë për qind të rasteve të aksidenteve”, ka deklaruar në KKSB, zv/komandanti i stacioni policor në Malishevë, togeri Istref Bytyqi.

Ndërsa përfaqësuesi i FSK-së, në KKSB, ofroi mbështetjen e FSK-së, në çdo aspekt, në veçanti, nëse kërkohet ndihma e saj në luftën kundër etheve hemorragjike, por edhe në rastet tjera, si Forcë e Sigurisë së Kosovës.

Në fund të mbledhjes së sotme, nga ana e shoqërisë civile, anëtar të KKSB-së, janë falënderuar zyrtarët e Policisë së Kosovës, për punën e mirë që janë duke bërë, në krijimin e ambientit të qetë për qytetarët e komunës së Malishevës.

Kilaj e Kvale inspektuan punimet në Qendrën e Kompetencës

Malishevë, 6 korrik

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj dhe ambasadori norvegjez z. Kvale, kanë inspektuar punimet në Qendrën e Kompetencës në Malishevë, e cila do të jetë gati për vitin shkollor 2010-2011.

Kilaj dhe Kvale, janë ndarë të kënaqur me punimet që janë duke vazhduar dhe Qendra e Kompetencës do të jetë gati për fillimin e këtij viti shkollor, përderisa kanë vizituar edhe ambientet e brendshme të objektit.

Objekti i Qendrës së Kompetencës në Malishevë, është njëri ndër objektet më moderne dhe me hapësirën më të madhe, në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë.

U mbajt mbledhja e tetë e radhës së Asamblesë Komunale

Këshilltarët shkojnë në pushim veror

Malishevë, 7 korrik

Është mbajtur mbledhja e tetë e radhës së Asamblesë Komunale të Malishevës, njëherit e fundit para pushimeve verore, ndërsa mbledhja e ardhshme, pritet të mbahet në shtator të këtij, viti, pasi muaji gusht, do të jetë muaj i pushimeve për 31 këshilltarët komunal.

Kështu u tha në fund të mbledhjes së Asamblesë Komunale, përderisa në mbledhjen e sotme, janë shqyrtuar tri rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, për Asamblenë Komunale.



Sipas rekomandimeve të KPF-së, është shqyrtuar një kërkesë e kompanisë Ben Aff, por në fund të kësaj pike, nuk u mor asnjë vendim për shkak të mungesës së kuorumit në sallë.

Po ashtu me rekomandim të KPF-së, janë debatuar edhe raportet e auditorit të përgjithshëm, për punën e Komunës së Malishevës, për vitet 2008 dhe 2009, ku nga ana e këshilltarëve, është kërkuar që të zbatohen rekomandimet e auditorit të përgjithshëm, edhe shihen përmirësime në zbatimin e rekomandimeve nga viti 2008 në vitin 2009.

Kryetari Kilaj priti qytetarët për më shumë se dy orë

Dëgjon hallet e tyre dhe ofron përkrahje

Malishevë, 8 korrik

Edhe në ditën e sotme, si çdo të enjte, Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka vazhduar traditën e pritjes së palëve, në zyrën e tij, duke u njoftuar kështu drejtpërdrejt me hallet dhe problemet e tyre dhe në të njëjtën kohë duke ju ofruar mbështetjen e tij dhe të komunës.

Përveç njoftimit me hallet dhe problemet e natyrave të ndryshme, kryetari Kilaj, ka marrë edhe falënderime nga ana e qytetarëve për asistencën e tij, në zgjidhjen e problemeve të ndryshme, që qytetarët kanë pasur, si problemet sociale, për përkrahje në shkollim, apo për dhënien e këshillave të ndryshme në raste të caktuara.

Edhe gjatë ditës së sotme, kryetari Kilaj, ju ka dhënë këshillimet e nevojshme qytetarëve, për çështje të caktuara, për mënyrën e procedimit të problemeve, dhe në përgjithësi, ju ka ofruar mbështetjen e tij, qoftë institucionale apo këshillime personale, duke u munduar që kështu t'ju ofroj ndihmë dhe mbështetje, për zgjidhjen e çështjeve që qytetarët kanë parashtruar para kryetarit.

Në Malishevë

Fillon fushata e korrjeve-shirjeve

Edhe zyrtarisht, sot ka filluar fushata e korrje-shirjeve në territorin e komunës së Malishevës, ndërsa raportet e para bëjnë të ditur se rendimentet e grurit janë rreth 3500 kilogram për një hektar, ndërsa kombajnerët po i përmbahen çmimit të caktuar, për 90 € për një hektar.





Sipas drejtorit të drejtorisë komunale për bujqësi, Sinan Kryeziut, shtabi i formuar për përcjelljen e fushatës së korrje-shirjeve, nga sot, është terren dhe po përcjell nga afër fushatën e korrje-shirjeve, dhe se sipas tij, autokombajnerët po i përmbahen çmimit prej 90 € për një hektar, pa lidhje të kashtës, ndërsa me lidhje të kashtës çmimi është 100 € për një hektar.

“Në këtë fillim të fushatës nuk vërehet mungesë e autokombajnave dhe gjithçka ka filluar mbarë, ndërsa rendimentet sillen rreth 3500 kilogram për hektar”, tha drejtori Kryeziu, ndërsa fushata e korrje-shirjeve, sipas Kryeziut, pritet të zgjatë rreth 20 ditë, por kjo varet nga kushtet atmosferike.

Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Kërkohet përgjegjësi në punë për shërbime efikase ndaj bashkatdhetarëve

Malishevë, 12 korrik

Kryetari i komunës së Malishevës, Isni Kilaj, ka kërkuar rritjen e disiplinës dhe nivelit të përgjegjësisë në punë, me qëllim të shërbimeve efikase ndaj qytetarëve, duke llogaritur këtu edhe fluksin e madhë të këtyre muajve.

“Kërkoj që gjatë këtyre muajve të shtohet edhe me shumë niveli i përgjegjësisë dhe disiplinës në punë, dhe në mënyrë sa më efikase të ofrohen shërbime ndaj qytetarëve, sidomos tani që fluksi i tyre është edhe më i madh, duke pas parasysh pushimet e bashkatdhetarëve”, kështu është shprehur kryetari i komunës së Malishevës, në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve.

Në këtë takim është njoftuar edhe për procesin e fillimit të regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme, përfshi këtu edhe regjistrimin e nxënësve në Qendrën e Kopetencës, ku sipas drejtorit për arsim, Isuf Morina, interesimi është mjaft i madh, ndërsa pritet të përfshihen 1400 nxënës që kanë përfunduar klasën e nëntë.

Në anën tjetër drejtori për shëndetësi, Skënder Hoti, ka njoftuar për përfundimin me sukses të fazës së dytë të spërkatjes selektive, për eliminimin e rriqrave, si masë parandaluese kundër infektimit nga ethet hemorragjike, përderisa në QKMF të Malishevës, ka ardhur një autoambulancë, donacion nga Luksemburgu. Drejtori i Inspektoratit, ka njoftuar se gjatë fundjavës, kanë ndërmarre një aksion të përbashkët me njësitët speciale të Policisë së Kosovës, ku kanë kontrolluar dhe bllokuar një lokal, në të cilin dyshohet për prishje të rendit dhe qetësisë, por edhe të tjera të cilat nuk i janë

përmbajtur orarit të punës. Për të gjitha këto raste janë përgatitur edhe paditë për në gjykata. Edhe drejtori për Bujqësi, Sinan Kryeziu, ka njoftuar për mbarëvajtjen e fushatës së korrije-shirjeve, e cila është duke shkuar mirë, e që pritet të përfundoj me 20 korrik.

Ansambli “Llapusha” nga Malisheva merr pjesë në festivalin ballkanik në Turqi

Malishevë, 14 korrik

Ansambli i këngëve dhe valleve “Llapusha” nga Malisheva, në nivel të shtetit të Kosovës, është ftuar të marrë pjesë në festivalin ballkanik të valleve, i cili mbahet në Turqi, konkretisht në Sansun Erbaa, nga data 15 deri më 19 korrik 2010.

Para nisjes (gjatë ditës së sotme), këtë ansambël e ka

pritur në takim, kryetari i komunës së Malishevës, Isni Kilaj, me ç’rast i ka përgëzuar për pjesëmarrje duke iu uruar suksese dhe prezantim të denjë të Republikës së Kosovës në atë festival.

“Besoj se do ta prezantoni denjësisht Kosovën e në veçanti Malishevën në atë festival”, iu ka thënë mes tjerash kryetari Kilaj, anëtarëve të Ansambilit të Këngëve dhe Valleve “Llapusha”, të Malishevës, duke iu dëshiruar njëkohësisht edhe rrugëtim të mbarë.

Koreografi dhe përfaqësuesi i këtij ansambli, Burim Thaçi, ka falënderuar komunën e Malishevës dhe kryetarin Kilaj për mbështetjen e dhënë, që ansambli të merr pjesë në këtë festival, duke u zotuar se do të mundohen që të prezantohen sa më mirë që është e mundur.





“Ne do të mundohemi që të prezantohemi sa më mirë që është e mundur, në mënyrë që ta prezantojmë Kosovën në këtë festival dhe në veçanti komunën tonë Malishevën. Ne si ansambël iu falenderojmë juve për mbështetjen e dhënë, duke na mundësuar pjesëmarrjen për herë të parë në një festival me karakter ndërkombëtar”, tha B.Thaçi.

Udhëtimin për pjesëmarrje në festivalin ballkanik në Turqi, të Ansambllit të Këngëve dhe Valleve “Llapusha” nga Malisheva, e ka mundësuar Komuna e Malishevës.

Në Qendrën e Kompetencës regjistrohen nxënësit e parë

Malishevë, 14 korrik

Ka përfunduar me sukses afati e parë i regjistrimit të nxënësve në shkollën e mesme profesionale, e njohur si Qendra e Kompetencës, për vitin shkollor 2010-2011. Praktikisht, kjo qendër ka filluar të funksionoj si vatrë shkollore, pasi pas përzgjedhjes së stafit menaxhues dhe mësimdhënësve, tani është bërë edhe regjistrimi i nxënësve.

Sipas drejtorit të Qendrës së Kompetencës në Malishevë, Besim Dobruna “interesimi për regjistrim në vitin e parë ka qenë mjaft i madh, për çka edhe ne si staf jemi të kënaqur”. Sipas drejtorit Dobruna, në përzgjedhjen e kandidatëve, janë përdorur kriteret e caktuara, ku aplikantët, është dashur të kenë më shumë se 50 poena, për tu regjistruar.

“Kanë aplikuar rreth 400 kandidatë, prej të cilëve 321 i kanë plotësuar kushtet për tu pranuar, të cilët kanë arritur ti kenë mbi 50 poena dhe ky numër i madh tregon interesimin e të rinjve për të studiuar në Qendrën e Kompetencës”, tha Dobruna.

Po ashtu është njoftuar se numri total i nxënësve që do të pranohen në Qendrën e Kompetencës, do të jetë 360, dhe pjesa tjetër prej 39 kandidatëve do të regjistrohen në afatin e dytë, diku ka pjesa e dytë e muajit gusht.

Qendra e Kompetencës, është një sistem i ri i arsimit të mesëm të lartë, si shkollë profesionale, me drejtime të caktuara ekonomike, juridike dhe në teknologji informative, ndërsa edhe hapësira e kësaj shkolle është njëra ndër më të mëdhat në rajon.

Vlen të theksohet se kjo shkollë profesionale, është donacion i Qeverisë së Norvegjisë dhe Ministrisë së Arsimit të Kosovës.



Asnjë semimaturant nuk do të mbetet jashtë bankave shkollore

Malishevë, 15 korrik

Në konkursin e parë për regjistrim të nxënësve në klasat e dhjeta (shkollimi i mesëm i lartë), në tri shkollat e mesme të komunën e Malishevë janë paraqitur 1038 kandidat, ndërsa klasat e nënta i kanë përfunduar 1360 nxënës.

Drejtori i Drejtorinë Komunale të Arsimit në Malishevë Isuf Morina, ka bërë të ditur se numri i kandidatëve të paraqitur në Gjimnazin “Abdyl Frashëri”, dhe Qendrën e Kompetencës është tejkaluar, përderisa vende të lira ka edhe më tej në SHMP “Lasgush Poradeci” në Kijevë.



“Në bazë të të dhënave, në Gjimnazin “Abdyl Frashëri” janë paraqitur për regjistrim 551, prej tyre janë pranuar 320; në Qendrën e Kompetencës në Malishevë janë paraqitur 397 aplikant, janë pranuar 321, ndërsa në SHMP “Lasgush Poradeci” në Kijevë janë paraqitur 90 kandidat, të gjithë janë pranuar”, ka bërë të ditur drejtori Morina. Sipas tij, vende të pa plotësuara kanë mbetur në SHMPEJ “Lasgush Poradeci”, ku mund të pranohen edhe 262 kandidat, ndërsa në Qendrën e Kompetencës, do të pranohen edhe 39 të tjerë.

Ndërsa sa i përket hapësirave shkollore, Isuf Morina ka bërë të ditur se “sikur dy vitet të kaluara, edhe sivjet do të përkujdesemi që asnjë nxënës të mos mbetet jashtë bankave shkollore, edhe pse krahasuar me vitet tjera, këtë vit jemi në pozitë më të mirë pasi kemi edhe Qendrën e Kompetencës”, tha drejtori Morina.

Ngritja e hapësirave të reja shkollore dhe krijimi i kushteve më të mira për nxënës në komunën e Malishevës, viteve të fundit ka bërë që të rritet edhe cilësia, pasi nxënës të shkollave të komunës sonë kanë treguar suksese në gara në nivel vendi, kurse ngritje e lartë e rezultateve është shënuar edhe në testin e semi maturës dhe maturës.

Fillon asfaltimi i rrugës në gjatësi 4 kilometra

Malishevë, 15 korrik

Ka filluar asfaltimi i rrugës Malishevë – Burim e gjatë 4 kilometra, në të cilën krahas shtëpive individuale të banimit janë të vendosura edhe blloqe të tëra të banesave si dhe Qendra e Banimit Social, lagjen “Pallanka” nga Dragobili si dhe fshatin Burim të kësaj komune.

Drejtori i Drejtorisë komunale të Urbanizmit Esat Paçarizi, ka bërë të ditur se projekti në fjalë kushton rreth 740.000 euro, është financuar nga Ministria e Transportit dhe Postë - Telekomunikacionit (MTPT) dhe Komuna e Malishevës.



“Rruga do të përmirësoj jetën e qytetarëve të këtyre lokacioneve dhe do të përmirësoj infrastrukturën e komunës”, ka thënë z. Paçarizi.

Ndryshe, prej kësaj gjatësie, 1.1 kilometër është e ndërtuar sipas standardeve të parapara prej 5.5 metrave gjerësi me trotuare dhe ndriçim. Projektin në fjalë po e realizon “Besi – Kompani”.

Blegtorët e Malishevës përfitojnë afro 100 mijë euro nga subvencionimi

Malishevë, 16 korrik

Blegtorët e Komunës së Malishevës, të cilët mbajnë kafshë të imta(dhi dhe dele) dhe lopë qumështore, kanë përfituar afro 100 mijë euro subvencione nga Ministria e Bujqësisë.



Sipas drejtorit të drejtorisë komunale për Bujqësi, Sinan Kryeziu, “36 blegtor delesh kanë përfituar 37.430 euro, kurse 17 blegtor të tjerë kanë përfituar 22.160 euro për mbajtjen e dhive, si dhe 164 fermer që mbajnë lopë qumështore kanë përfituar 34.560 euro nga subvencionimi i këtij viti”. Po sipas tij, “kjo është shtytje për blegtorët dhe me siguri do të ndikoj në rritjen e krerëve të kafshëve të imta dhe të trasha”.

Ky subvencionimin, nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, është një shtytje e zhvillimit të bujqësisë, dhe vlerësohet mjaftë efektiv, duke e pas parasysh edhe shtimin e prodhimeve vendore. Gjithashtu një ndihmë e tillë, është motivim për të gjithë të interesuarit, që dëshirojnë të merren me kultivimin e kafshëve sikur janë në këtë rast, lopët qumështore, delet dhe dhitë.

KD :“Të ndihmohen familjet me ujë të pijes”

Malishevë, 19 korrik

“Të ndihmohen të gjitha familjet që e kanë problem sigurimin e ujit për pije”, kështu është thënë në mbledhjen e rregullt (të ditës së sotme), të Këshillit të Drejtorëve, të udhëhequr nga kryetari i komunës, z.Isni Kilaj. Kilaj ka kërkuar nga të gjitha drejtoritë përgjegjëse që të sigurojnë ujin për pije, për familjet të cilat e kanë këtë problem.

Në mbledhjen e sotme, përgjegjësit e drejtorive, kanë njoftuar mbi punën e tyre, në veçanti nga drejtoria e arsimit, për hapjen e konkursit për mësimdhënës në shkollat e komunës sonë, pastaj mundësia e ndërtimit të aneksit të shkollës në fshatin Marali, nga drejtoria për shëndetsi është njoftuar se tashmë rreziku nga thumbimi i rriqrave ka kaluar, ndërsa drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, ka njoftuar për katër raste të zjarreve gjatë javës që lamë pas, me ç’rast është intervenuar nga brigada e zjarrfikësve dhe shpëtimit (një kulm shtëpie në Banjë, dy raste të djegies së ushqimit për kafshë dhe një rast në fushë të hapur).

Komuna dhe CHF do të ndërtojnë aneksin e shkollës në Marali

Malishevë, 21 korrik

Kryetari i komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj dhe përfaqësuesi i CHF-së (Cooperative Housing Foundation), zyra në Prishtinë, Ian Schneider, sot kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për bashkëfinancim, për ndërtimin e një aneksi të shkollës fillore në Marali, projekti ky, i cili do të realizohet gjatë vitit 2011.

Qëllimi i këtij memorandum është, përmirësimi i infrastrukturës në shkollat ekzistuese, gjegjësisht zgjerimi dhe përmirësimi i hapësirës fizike, përmes ndërtimit të aneksit, përmes së cilës do të zvogëlohen edhe ndërrimet e orarit të mësimi në këtë shkollë.

“CHF, përmes zyrës së saj në Prishtinë, është e gatshme të ofroj investime strategjike drejt përmbushjes së





synimeve të Komunës për Arsimin, përmes programit për Kosovën, ‘Infrastruktura e Vogël për Arsimin në Kosovë’, financuar nga USAID”, thuhet më tutje në marrëveshjen e nënshkruar.

“Unë ju falënderoj për investimin tuaj në ndërtimin e këtij aneksi, kurse për neve kjo ndihmë është e madhe dhe unë e vlerësoj shumë. Ne jemi të gatshëm për bashkëfinancim”, i tha përfaqësuesit të CHF-së, kryetari i komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj.

OSBE prezanton kornizën ligjore për qasje në dokumentet zyrtare

Malishevë, 26 korrik

Misioni i OSBE-së në Kosovë, bashkë me Komunën e Malishevës, kanë organizuar një takim, përmes të cilit është bërë prezantimi i kornizës ligjore për qasje në dokumentet zyrtare në Kosovë.

Në këtë prezantim janë trajtuar temat si: fushëveprimi i ligjit, përjashtimet në zbatimin e tij, klasifikimi i dokumenteve komunale, si dhe kërkesa për qasje në dokumente zyrtare.

“Prioritet i kemi dhënë hapit, për qasje në dokumentet zyrtare, me qëllim të rritjes së prezencës së qytetarëve në vendimmarrje”. Kështu është shprehur zyrtari i lartë i OSBE-së për regjionin e Prizrenit, Olivier Bricet.

Prezantimi në lidhje me qasjen në dokumentet zyrtare është bërë nga z. Adem Kollari, zyrtar i OSBE-së, sipas të cilit, “qëllimi i këtij prezantimi ka të bëjë me pasqyrimin e dy dokumenteve kryesore mbi qasjen në dokumentet zyrtare: Ligji mbi qasjen në dokumentet zyrtare Nr.2003/12 e shpallur me rregulloren e UNMIK-ut 2003/32; dhe Udhëzimi administrativ nr.2006/03 për zbatimin e Ligjit për qasje në dokumente zyrtare”. Më pastaj është fol rreth fushëveprimit të ligjit, përjashtimet nga e drejta e qasjes në dokumente zyrtare, klasifikimin e dokumenteve zyrtare, regjistrimi i dokumenteve zyrtare, kërkesës apo aplikimit për qasje në dokumente zyrtare, etj.

Kryetari Kilaj i premtonte mbështetje financiare, pilotit lobues James Berisha

Malishevë, 27 korrik

Pilotit të njohur, James Berisha, i cili me moton “Unë fluturoj për Kosovën”, po udhëton nëpër botë me mision lobimi pro njohjes së pavarësisë së Kosovës, i është premtuar ndihmë financiare nga kryetari i Komunës së Malishevës, Isni Kilaj.

Ky premtim i është dhënë sot, në takimin e zhvilluar në mes kryetarit të



komunës së Malishevës, dhe pilotit shqiptar me shtetësi amerikane James Berisha.

“Kam vendosur që më misionin tim ‘Unë fluturoj për Kosovën’, të shkoj në Kontinentin e Afrikës”, është shprehur Berisha. Sipas tij, në lidhje me këtë qëllim, deri më tanë janë vizituar 34 shtete të botës.

Kryetari i komunës së Malishevës, z. Kilaj, e ka përgëzuar pilotin lobues, për punën e tij në lidhje me çështjen e njohjes së shtetit të Kosovës, ndërkohë që i ka premtuar atij mbështetje financiare, në mënyrë institucionale.